VENDIM
Nr. 158, datë 5.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GREENSOL" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/1 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Greensol' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Greensol" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a", "b", "c" dhe "d".

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe "c".

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "b" dhe "d".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria "Greensol" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.2.2026, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 49.96 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, nga shoqëria 'Greensol' sh.p.k.";

- Është pajisur me miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës me nr. 1994/2 prot., datë 23.5.2025, të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë;

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa "c": Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa "b": Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për 20% e mbetur të vlerës totale të investimit të projektit;

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1, Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa "a": Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit;

- germa "c": Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare me "OST" sh.a. dhe nëse po, ta depozitojë atë në ERE;

- germa "e": Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprake të përditësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Greensol" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Greensol" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti